

LIGJ
Nr.7543, datë 24.12.1991

PËR TATIMIN MBI QARKULLIMIN E MALLRAVE

Në mbështetje të neneve 13 e 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Personat juridikë a fizikë që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare, paguajnë tatim mbi qarkullimin e mallrave.

Neni 2

Tatimi mbi qarkullimin e mallrave zbatohet për të gjitha mallrat që shiten në Shqipëri, pavarësisht nëse prodhohen brenda vendit apo importohen nga jashtë, me përjashtim të mallrave që shiten në rrjetin e tregtisë me pakicë dhe atyre që eksportohen.

Personat juridikë a fizikë, që realizojnë një qarkullim mallrash deri 8 milionë lekë në vit përjashtohen nga tatimi mbi qarkullimin e mallrave.

Neni 3

Tatimi mbi qarkullimin e mallrave llogaritet në masën 15 për qind. Shitësi e shton tatimin mbi çmimin e shitjes në faturë dhe mblesh tatimin nga blerësi për llogari të shtetit.

Disa nga ndërmarrjet e industrisë nxjerrëse të mineraleve dhe të naftës që caktohen nga Ministria e Financave dhe Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike paguajnë këtë tatim në masën 1 për qind për dy vitet e para.

Neni 4

Për mallrat që prodhohen brenda vendit, tatimi mbi qarkullimin e mallrave llogaritet në bazë të vlerës të çdo sasive malli të shitur me çmimet korrente.

Neni 5

Për mallrat që importohen, tatimi mbi qarkullimin e mallrave llogaritet në bazë të vlerës të doganuar, duke shtuar edhe shumën e taksës doganore.

Neni 6

Për mallrat që prodhohen brenda vendit, detyrimi për pagimin e tatimit mbi qarkullimin e mallrave fillon nga koha kur shitësi nis faturën në adresë të blerësit.

Neni 7

Për mallrat e importuara tatimi mbi qarkullimin e mallrave paguhet menjëherë me pagimin e taksës doganore.

Neni 8

Tatimi mbi qarkullimin e mallrave derdhet në buxhetin e shtetit. Shitësi i mallrave detyrohet të llogaritë dhe të derdhë në buxhetin e shtetit tatimin mbi qarkullimin mallrave çdo 10 ditë.

Neni 9

Ministria e Financave ka të drejtë të caktojë afate të detajuara për pagimin e tatimit mbi qarkullimin e mallrave.

Neni 10

Shitësit dhe importuesit e mallrave detyrohen të mbajnë llogari të veçantë për tatimin mbi qarkullimin e mallrave, të plotësojnë dhe të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike mujore mbi tatimin e realizuar, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Ministria e Financave.

Neni 11

Quhen shkelje të këtij ligji:

- Fsrehjet e tatimit mbi qarkullimin e mallrave.
- Falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve bazë për llogaritjen e tatimit.
- Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël të tatimit mbi qarkullimin e mallrave.
- Derdhja me vonesë e tatimit në buxhetin e shtetit.
- Paraqitja me vonesë pa shkaqe të arsyeshme e deklaratës periodike mujore mbi tatimin e realizuar.

Neni 12

Shkeljet e parashikuara në nenin 11, pavarësisht nga ndjekja penale, dënohen edhe me këto masa administrative:

- Fsrehja dhe falsifikimi i tatimit mbi qarkullimin e mallrave, me gjobë sa 5-fishi i shumës së tatimit të fshehur ose falsifikuar, si dhe me marrjen e tatimit të fshehur në masën 100 për qind.
- Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël, me gjobë deri në 4000 lekë, sipas masës së gabimit të bërë.
- Derdhja me vonesë e tatimit në buxhetin e shtetit, me gjobë 1000 lekë, dhe me pagimin e kamatëvonesës në masën 0,10 për qind për çdo ditë vonesë.
- Paraqitja me vonesë pa shkaqe të arsyeshme e deklaratës periodike mujore mbi tatimin e realizuar dënohet me gjonë 1000-3000 lekë.

Neni 13

Të drejtën e vendosjes së gjobave dhe arkëtimin e kamatëvonesave e kanë inspektorët e tatimeve në rreth ose punonjësit e drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të tij përkatësisht te përgjegjësi i seksionit të financës ose te drejtori i drejtorisë së tatimeve, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 14

Për mallrat, që me ligj të veçantë zbatohen akcizat, tatimi mbi qarkullimin e mallrave nuk zbatohet.

Neni 15

Tatimi mbi qarkullimin e mallrave nuk zbatohet për produktet ushqimore bazë të caktuara në

udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave.

Neni 16

Ministria e Financave ngarkohet të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 17

Dekreti nr.112, datë 26.7.1950 "Për tatimin mbi xhiro të ndërmarrjeve ekonomike", dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1992.

Shpallur me dekretin nr.106, datë 6.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia